



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1097/ 6 prot

Datë 09.06.2022

V E N D I M
K.P.P.550/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24122-04-05-2022 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 2,558,653.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.05.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Kadiu” SHA
Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Mëzez, Ndërtesë Private , Zona Kadastrale Nr.2679, Nr. Pasurie 19
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Alstezo” SHA
Fier, Lagjja “Kryengritja e Fierit”
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.04.2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24122-04-05-2022 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 2,558,653.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.05.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 06.05.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “ALSTEZO” SH.A	1,249,840	lekë	kualifikuar
- “KADIU SH.A” SH.A	1,929,167	lekë	kualifikuar
- “VILNIK MOTORS” SH.A	2,068,000	lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 23.05.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit, prej të cilit rezulton fitues operatori ekonomik “Alstezo” SH.A.

II.4. Në datën 23.05.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2022/2212 dhe me nr. 1097 prot., datë 23.05.2022 e operatorit ekonomik “Kadiu” SHA, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SH.A.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit u publikuan pretendimet e operatori ekonomik ankimues “Kadiu” SHA lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SH.A.

II.6. Me shkresën nr. 914 prot., datë 03.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1097/5 prot., datë 06.06.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kadiu” SHA, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “Alstezo” SHA me datë 31.05.2022 protokolluar me tonën nr. 1097/4 prot., ka dorëzuar në formë shkresore argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së të cilat rezultojnë të paraqitura jashtë afatit të përcaktuar nga lex specialis.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Kadiu” SHA , për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA, me arsyen se:

“Nisur nga rrethanat dhe faktet, si edhe nga pjesëmarrja e OE te tjere ne kete procedure verejme se OE Alsteso ka ofertuar ne vleren me pak se 50% te fondit limit. Menyra e ofertimit te bere prej ketij OE nuk eshte e para ne kete menyre. Edhe ne procedura te tjera ka bere kete menyre ofertimi. Kadiu ShA si nje operator i vjeter ne treg ne llogaritjet qe ka bere e sheh te pamundur realizimin e detyrimeve sipas DST nga Alsteso me vleren qe ka ofertuar. Per kete kerkoj qe te rivlersohet ne detaje kjo procedure dhe skualifikimin e Alsteso si te pabazuar ne kriteret e percaktuara ne vlleresimin e ofertave.” K.P.P vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së, me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1097/5 prot., datë 06.06.2022, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e operatorit ekonomik “Alstezo” SHA është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO me datë 18.05.2022 nëpërmjet SPE, i është drejtuar operatorit ekonomik “Alstezo” SHA me kërkesë që brenda 3 ditëve pune të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalish të ulët, të cilat duhet t’i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shkresore.

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1097/5 prot., datë 06.06.2022, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 18.05.2022 operatori ekonomik “Alstezo” SHA ka ngarkuar në SPE argumentimin në mënyrë të përgjithshme me qëllim justifikimin e ofertës anomalisht të ulët, si dhe me shkresën e datës 18.05.2022 protokolluar në autoritet kontraktor me nr.800 prot., datë 18.05.2022, ka paraqitur në mënyrë shkresore me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dokumentacionin si më poshtë:

- *Shkresë datë 29.04.2022 Kthim përgjigje: Sqarime Oferta Anomalisht e Ulët*
- *Deklarata e doganore nr. R 69513, datë 21.07.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 1095/21, datë 23.06.2021.*
- *Deklarata e doganore nr. R 123784, datë 16.12.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 2034/21, datë 19.11.2021.*
- *Deklarata e doganore nr. R 73334, datë 31.07.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 21071496, datë 31.07.2021.*
- *Deklarata e doganore nr. R 2984, datë 18.01.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. SIN 655867 e datës 20.12.2021*
- *Deklarata e doganore nr. R 28639, datë 28.03.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. SIN 669388 e datës 14.03.2022*
- *Deklarata e doganore nr. R 47244, datë 25.05.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 171412, datë 14.05.2021.*
- *Deklarata e doganore nr. R 106270, datë 23.12.2020 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 273075, datë 27.11.2020.*
- *Deklarata e doganore nr. R 736910, datë 10.08.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. A1622-07826 datë 23.07.2021*
- *Deklarata e doganore nr. R 98991, datë 02.12.2016 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 1699, datë 11.11.2016.*
- *Deklarata e doganore nr. R 102621, datë 10.11.2017 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 2017 FE 444*
- *Deklarata e doganore nr. R 10307, datë 07.02.2022 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 22E/00098 datë 21.01.2022*
- *Deklarata e doganore nr. R 65513, datë 21.07.2021 bashkëlidhur së cilës fatura e blerjes me nr. 1095/21, datë 23.06.2021.*

- *Tabelë me të dhënat lidhur me analizën për ofertën anomalisht të ulët (emërtimi i riparimit, , njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi, vendi i origjinës, kodi i furnitorit te blerjes pjesë këmbimi, çmimi i blerjes pjesës këmbimit/ofertes, nr. dhe data e fatures se blerjes se pjeses se kembimit, nr. dhe data e faturës se zhdoganimit, shpenzime transporti, shpenzime te takses doganore, shpenzime te takses doganore per vajin (akciza), cmimi perfundimtar i blerjes i konvertuar ne lek, cmimi i puntorisë, vlera totale e kostos se riparimit (perfshire pjesen e kembimit).*
- *Listën e disa zërave me kodet përkatëse sipas shoqërisë Marzocca, BGAutomative LTD, Cofle, Impergom, Japko.*

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) *anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) *zgjdhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) *originalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) *pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- d) *mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

3. *Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]*”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Alstezo” SHA, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 1249840.00 lekë pa TVSH , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfutur ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm

përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

- III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “Alstezo”SHA është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Alstezo” SHA, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës me nr.17/5 prot., datë 18.05.2022 me lëndë “Sqarim i ofertës ekonomike”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: Lidhur me anen ekonomike te procesit të furnizimit & vendosjes pjesë shërbimit,shërbimit, apo shërbimit to te mjeteve, po ju paraqesim tabelen bashkëngjitur ketij material, ne te. cilen jane te pershkruar ne menyre te sintetizuar dhe korrekte te gjitha te dhenat qe nevojiten per nxjerrjen e kosos se pjeseve te kembimit dhe hakut te punes per cdo ze riparimi, si per montimin e pjeses ashtu edhe shërbimit (hakut punes ne vetvete) Konkretisht kemi bërë analizën si vijon:

- Kemi paraqitur çmimin e blerjes se pjeses kembimit ne Fabrikat (bashkëngjitur faturat e blerjes se mallit dhe dokumentin perkates per zhdoganimin e mallit me te cilen ne bashkepunojme dhe furnizohemi .

- Kemi paraqitur proformat lidhur me çmimet e blerjes te ofruara ONLINE nga furnoret jashte vendit me te cilet ne bashkepunojme ne procesin e blerjes se pjeseve te kembimit të nevojshme per riparim te mjeteve.

- Kemi paraqitur koston e taksës doganore edhe pse ne rastet kur kemi te bejme me artikujt qe nuk jane te komunitetit EU, pra jane pa EURO 1 (pasi dihet qe mallrat me Euro 1 e kane taksën doganore 0) ne e kemi konsideruar taksën doganore 2%.

- Kemi paraqitur koston e transportit nga depozita ne Bari deri ne Magazinat tona nderkohe si kosto te transportit kemi marre parasysh mesataren e kosos se transportit qe eshte paguar gjate se kryerjes se importeve nga Italia (fabrikat qe ne importojme: pjese kembimi jane vetem nga Italia) e cila ne asnje rast nuk e kalon masen deri ne 2% max 5%. Per rastin e pjeseve te kembimit te furnizuara nga Kompanite FEBEST dhe BGA, kosto e transportit deri ne destinacionin e magazines tone ne Shqiperi (Tirane) eshte 0, pasi eshte perfshire ne çmimin e paraqitur ne faturen perkatese te Kompanisë furnizuese.

- Kemi paraqitur fatura blerje ne tregun brenda vendit te disa artikujve pjese kembimi nga te cilet ne bashkepunojme, te cilat nevojiten ne procesin riparimit te): mjeteve (ne kete rast taksat doganore dhe kosto e transportit jane me vleren 0).

- Kemi paraqitur kosto te montimit te pjeses se kembimit gjate procesit te riparimit, - ne keto raste kemi marre parasysh koston e hakut te punes e cila eshte e llogaritur mbi bazen e kohes se punes qe nevojitet per montimin e pjeses se kembimit si dhe kohen e kryerjes se sherbimit ne rastin kur nuk kerkohet nderrim te pjeses se kembimit perfshire te gjitha detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore, pra si kosto te sherbimit apo riparimit ne rastet kur ka vetem hak pune, jane referuar cmimet sipas zerave te riparimit perkatesisht, duke kalkuluar kohen e punes (puntorine) shpenzimet per sigurimet shoqerore, energjine e harxhuar, taksat vendore, taksat per pasurine ...etj.

Perfundimisht, nga analiza e bere, rezulton qe vlera totale e koston se riparimit (perfshire pjesen e kembimit) eshte X leke.

Ne argumentimet tona shkesore kemi paraqitur edhe nje table ilustruese me te dhena konkrete te sakta per cdo pjese kembimi dhe cdo ze riparimi, sikurse kerkohen ne DT.”

b) Lidhur me zgjidhjet teknike: Shoqeria ALSTEZO ShA ka nje eksperience 29 vjecare (krijuar ne Vitin 1993 si autoservis dhe pjese kembimi per automjete) dhe sot eshte shoqeria “lider” ne Shqiperi per riparimin dhe sherbimet e mjeteve si ato private, ashtu edhe shteterore. Kusht favorizues eshte pikerisht fakti qe Shoqeria ka disa pika kontrolli teknike shumefunksionale dhe moderne, te cilat sherbejne ne hyrje te mjetit per riparim dhe kontrol ne dalje te tij. Pikat e kontrollit jane shume modeme dhe plotesojne te gjitha paramcirat teknike duke bere te mundur kontrollin e mjetit, pra diagnostikimin e difeketeve dhe percaktimin e gjendjes teknike aktuale te mjetit ne kohe reale lidhur me gjithe proceset e punes te nevojshme gjate kontrollit, si para, ashtu edhe pas procesit te riparimit te mjetit. Ne serviset qe ne disponojme kryhen gjithë proceset e punes per riparim te mjeteve, “nga A ne Z” sikurse jane ato motorrike, clektrike, elektronike, sistem ushqimi, percaktimi i nivelit te gazrave (lidhur me ndotjen e ambientit) pastrimin e motorrit me H2, pastrimin e marmides katalitike me pajisjet bashkekohore PDF (teknologjie vitit 2019-2021, ...etj.) Reparti i karrocriste (riparimi llamarines dhe bojatisja) janc me modernet ne vend dhe ne rajon duke filluar qe nga repartet e zmontimit te mjetit, drejtimit . - te shasive, riparimit llamarines, lyerjes me bojce ne furra modernc., etj. Personeli Inzhinierik i shoqerise ALSTEZO sha eshte i specializuar dhe diplomuar. ne shtetet perendimore, po ashtu edhe personeli tjetere teknik, i cili eshte i pajisur me deshmitet profesionale, te cilat jane te konkretizuara nepermjet detyrave te percaktuara ne: kontarten e punes perkatesisht per cdo punemarres ne vecanti.

c) Sa i perket origjinaliteti te mallrave, Shoqeria ALSTEZO sha eshte importuese direkt e te gjitha pjeseve te kembimit qe nevojiten per riparimin ee mjeteve. Importi behet ne rang produkti (multimarket) dhe disponibiliteti i pjeseve te kembimit eshte 100% ne kohe reale.

Bashkengjitur pervec faturave te blerjes se pjesëve te këmbimit/mallra si dhe ofertave kemi paraqitur edhe Autorizimet e prodhuesit/distributorit si dhe deklarime te ndryshme autentike lidhur me origjinën dhe konformitetin e pjesëve te kembimit te cilat provojnë katërcipërisht bashkëpunimin që ne kemi me furnoret e pjesëve të këmbimit të cilat do të shërbejnë për

realizimin e kontrates/Marrveshje Kuader objekt i kësaj procedure prokurimi. Per cdo rast ne cdo dokument jane te shenuar edhe adresat perkatese si ato te vendit te ushtrimit te aktivitetit ashtu edhe elektronike nr. Tel etij.Konkretisht në këtë procedurë kemi paraqitur autorizimet e prodhuesit/ distributorit të autorizuar për :

Metelli SPA, Impergom SRL, Sirena Srl, Wolf Oil, Febest, BGAutomative, Japan parts, Cofle srl, Marzocca, Tecneco Filtri srl.

.....

d) Lidhur me zbatueshmerine e detyrimeve Shoqëria Alstezo ka ambiente pune shumë bashkëkohore dhe me standartet e një performance europiane.”

.....

Përveç kësaj, KPP vëren, se operatori ekonomik “Alstezo” SHA në mbështetje të deklaramë sipër, me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka përcaktuar përmes një tablele një analizë për të gjithë artikujt objekt-prokurimi, duke detajuar analizën e kostos në trajtë analitike e konkretisht duke përcaktuar: *(emërtimi i riparimit, njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi, vendi i origjinës, kodi i furnitorit te blerjes pjesë këmbimi, çmimi i blerjes pjesës këmbimit/ofertës, nr. dhe data e fatures se blerjes se pjeses se kembimit, nr. dhe data e faturës se zhdoganimit, shpenzime transport 5%, shpenzime te taksës doganore 2%, shpenzime te taksës doganore per vajin (akciza), cmimi perfundimtar i blerjes i konvertuar ne lek, cmimi i puntorisë, vlera totale e kostos se riparimit (perfshire pjesen e kembimit) prej X lekë.*

Gjithashtu, ankimesi ka paraqitur Deklarata Doganore siç janë përmendur në pikën III.1.2 të këtij vendimi, si dhe ka ngarkuar në sistem edhe fatura të tjera tatimore të blerjes së pjesëve të këmbimit. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se operatori ekonomik “Alstezo”SHA ka dorëzuar edhe certifikata konformiteti dhe autorizime prodhuesi ose distributori të autorizuar nga shoqëri të ndryshme si: Metelli SPA Impergom Srl, Siena Srl, Wolf Oil, Febest, BGAutomative, Japan Parts, Cofle Srl, Marzocca, Tecneco Filtri srl .

Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon të shoqëruara me dokumente provuese, operatori ekonomik “Alstezo” SHA ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP-së, ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjitha elementet, duke përfshirë edhe koston e taksës doganore, koston e transportit, koston e montimit të pjesëve të këmbimit gjatë procesit të riparimit (çmimi i punëtorisë). Pra, operatori ekonomik “Alstezo” SHA, ka detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë. Gjithashtu, operatori ekonomik “Alstezo” SHA ka argumentuar edhe elemente të tjera favorizuese në përmbushje të kushtit për zgjedhje teknike të favorshme, si eksperiencia e gjatë në treg, realizmi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme, lidhjet me prodhuesit, disponimin e disa pikave të kontrollit teknik shumëfunktionale, disponimin e stafit inxhinierik të kualifikuar duke i provuar të gjitha deklaramet e tij me dokumentacion justifikues. Për sa i përket origjinalitetit të mallrave, operatori ekonomik “Alstezo” SHA, përveçse ka paraqitur faturat tatimore dhe deklaratat e zhdoganimit të disa prodhuesve ose distributorëve të autorizuar, ai ka paraqitur gjithashtu edhe deklaratat të konformitetit, autorizimin e prodhuesit apo distributorit të autorizuar, të cilat provojnë bashkëpunimin me palët më sipër për realizimin e kontratës. Akoma më tej, Komisioni vëren, se operatori ekonomik “Alstezo” SHA në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka ngarkuar

në sistem edhe listëpagesat e punonjësve, deshmi dhe diploma të stafit inxhinierik, certifikata kualifikimi të stafit teknik, foto të ambienteve të punës, licenca në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë, leje mjedisore etj. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se ankimesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së, duke argumentuar në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij dhe duke analizuar në mënyrë të detajuar secilin prej tyre.

III.7. Komisioni gjykon, se një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Alstezo” SHA, janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet siaps parashikimeve të *lex specialis* për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Kadiu” SHA, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kadiu” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24122-04-05-2022 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 2,558,653.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.05.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kadiu” SHA.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

